

Anketa për pritjet inflacioniste dhe pritjet për lëvizjen e PBB-së reale**- qershor 2024 -**

Anketa për pritjet inflacioniste dhe pritjet për lëvizjen e PBB-së¹ për periudhën 2024-2026, e zbatuar në qershor², tregoi normë mesatare pak më të ulët të inflacionit (për këtë vit), si dhe rritje më të ulët të PBB-së. Analistët ekonomik edhe më tej i lidhin pritjet e tilla para së gjithash me ngadalësimin gradual të rritjes vejtore të çmimeve në periudhën e fundit, përderisa rreziqet më të mëdha lidhen me konfliktin ushtarak në Ukrainë, konfliktin e Lindjes së Mesme, si dhe ndikimin e ndryshimeve klimatike, ku theksojnë se ende ekziston pasguri e lartë në lidhje me rrjedhën e zhvillimeve të ardhshme.



Sa i përket **inflacionit**, të anketuarit edhe më tej presin ngadalësimin e tij gradual. Krahasuar me anketën paraprake, të anketuarit në këtë anketë presin normë pakë më të ulët të inflacionit prej 3,9% për vitin 2024 (4,1% në anketën e mëparshme), gjatë pritjeve të pandryshueshme për vitin 2025 (3%) dhe pritje të ngjashme për vitin 2026 (2,7%, kundrejt 2,6% në anketën e mëparshme). Të anketuarit ende presin presione më të moderuara mbi inflacionin si rezultat i stabilizimit gradual të çmimeve të ushqimit dhe energjensave, dhe gjithashtu pritet se për ngadalësim të inflacionit do të kontribuojnë edhe masat e marra nga politikbërësit, si dhe ngadalësim të inflacionit të huaj. Si faktorë që mund të shkaktojnë presione për rritjen e inflacionit, të anketuarit edhe më tej i theksojnë kohëzgjatjen dhe pasigurinë rreth zgjidhjes së luftës në Ukrainë dhe të konfliktit në Lindjen e Mesme, si dhe ndryshimet klimatike mbi çmimet e produkteve primare. Gjithashtu, të anketuarit konsiderojnë se rritjet e mundshme të pagave si rezultat i zhvillimeve të tregut të punës, si dhe përkeqësimet e mundshme në furnizimin me energjinë dhe rritja e çmimeve të tregut të rregulluar mund të çojnë në presione të reja inflacioniste.

Në aspektin e **aktivitetit ekonomik**, tek norma e pritshme e rritjes është bërë korigjim i vogël në rënie. Kështu, të anketuarit presin rritje ekonomike prej 2,3% këtë vit (2,6% në anketën e mëparshme), 3,1% për vitin 2025 (3,3% në anketën e mëparshme), dhe për vitin 2026 pritjet prej 3,7% (3,8% në anketën e mëparshme). Sa i përket faktorëve, të anketuarit edhe në këtë anketë i theksojnë pespektivat e përkeqësuarra për rritje të ekonomive të partnerëve kryesorë tregtar, pasiguria për rrjedhën e ardhshme të luftës në Ukrainë, konflikti në Lindjen e Mesme dhe ndryshimet klimatike dhe ndikimi i tyre mbi zingjirët e furnizimit. Në mënyrë të pafavorshme mund të veprojnë edhe përmbajtja e investitorëve vendas dhe të huaj, gjatë shtrëngimit të politikës monetare në korniza globale dhe rritje të mëtutjeshme të kostove për financim. Gjithashtu, të anketuarit ende e përmendin pasigurinë lidhur me rrjedhën e negociatave me BE-në si faktor i mundshëm i kufizimit të rritjes ekonomike në periudhën e ardhshme. Nga ana tjetër, të anketuarit konsiderojnë se pas përfundimit të procesit zgjedhor dhe formimi i qeverisë së re mund të vjen deri në tejkalimin e pasigurisë të skenës së brendshme politike dhe do të vazhdohej me zbatim të përsheptuar të projekteve investuese, para së gjithash lidhur me infrastrukturën rrugore edhe në sektorin




¹ Në vitin 2017, Banka Popullore bëri ndryshim në hulumtimin e anketës "Anketa për pritjet inflacioniste", që është zbatuar në "Anketa për pritjet inflacioniste dhe pritjet për lëvizjen e PBB-së reale", struktura e re të cilit e monitoron pyetësorin tremujor për parashikuesit profesionistë (Quarterly Survey of Professional Forecasters, https://www.ecb.europa.eu/stats/ecb_surveys/survey_of_professional_forecasters/html/index.en.html), që e zbaton Banka Qendrore Europiane (BQE) dhe njëkohësisht e ndryshoi edhe strukturën e ekzemplarit, që tani është i përbërë vetëm nga ekspertët ekonomik.

²Anketa u zbatua në periudhën prej 10 deri 17 qershor të vitit 2024.

e energjisë. Gjithashtu, stabilizimi gradual i inflacionit, dhe me atë edhe ulja e mundshme e normave të interesit, si dhe rritja e pagave dhe pensione, mund të kontribuojnë për rritjen e konsumit personal dhe investimeve, që do të reflektonte pozitivisht në rritjen ekonomike.






Në kuadër të Anketës, të anketuarit japin edhe mendimin e tyre për **shpërndarjen e probabilitetit për realizimin e normave të përcaktuara në interval të caktuar**. Këto vlerësime përdoren për krijimin e shpërndarjes agregate të probabiliteteve³. Shpërndarja agregate e probabiliteteve për realizimin e normave të dhëna të inflacionit dhe PBB në pesëmbëdhjetë intervale është shfaqur në grafikonët në vijim, dhe rezultatet kryesisht përputhen me normat që i presin të anketuarit.



³Shpërndarja agregate e probabiliteteve paraqet mesatare nga vlerësimet e të anketuarve për probabilitetet, për çdo interval të normës së pritjeve të inflacionit dhe norma e rritjes së PBB-së.

Lidhur me pritshmëritë për **normat e inflacionit**, shpërndarja e probabiliteteve për këtë dhe për dy vitet e fundit tregon në zhvendosje dhe përqëndrim më të madh në dhe rreth intervaleve të normës së pritur mesatare.



Kur bëhet fjalë për zhvendosjet në shpërndarjen e probabiliteteve për **normën e pritur të rritjes së PBB-së**, ato gjithashtu janë më të përqëndruara në dhe rreth intervalit të normës së pritur mesatare.